



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.116/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada - Glligjani anëtarë, me pjesmarrjen e zyrtarit ligjor, Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Prishtinë, paraqitur kundër koalicionit LDK-AKR dega në Dardanë, për shkak të vendosjes së posterit në shenja publike të trafikut, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me datë 07.06.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**Pranohet** si e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Prishtinë, dhe koalicionit LDK-AKR dega në Dardanë i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 2,500.00 (dymijë e pesëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

### A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 06.06.2017, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me të cilën pretendon se me datën 05.06.2017, rreth orës 16:25 në rrugën “Skëndërbeu” në Dardanë, aktivistja Brikenë Ramabaja ka vërejtur se është vendosur në shtyllë elektrike, pra në hapsira publike një poster i kandidatit Shaip Surdulli për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës nga radhët e koalicionit LDK-AKR. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së nenit 4.1 pika b i Rregullës Zgjedhore të KQZ-së nr.11/2013, neni 3.4 i Rregullës Zgjedhore nr.13/2014, vendosja e materialit zgjedhor në apo mbi rrugë publike përbënë veprim të ndaluar për subjektet politike, kandidaët dhe mbështetësit e tyre . Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur një fotografi nga vendi ku ka ndodhur shkelja e Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët.

Në përgjigjen në ankesë i datës 07.06.2017 koalicioni LDK-AKR, ka pranuar shkeljen e pretenduar në ankesë duke arsyetuar se kemi vepruar konform dispozitave të nenit 120 paragrafi 1 pika a) i LZP-së, duke udhëruar kandidatin që të ndërmarrë veprime përmirësuese, nga të cilat veprime është evituar shkelja e pretenduar sipas ankesës. Koalicioni LDK-AKR e ka vendosur posterin e kandidatit për deputet dhe se koalicioni LDK-AKR pas marrjes së ankesës nga ana e PZAP-së kanë ndërmarr masat përmirësuese, për evitimin e shkeljes sipas ankesës. Përgjigjes në ankesë si provë për të dëshmuar pretendimet e tyre i kanë bashkangjitur dy foto nga vendi ku është larguar posterit

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoj shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 i LZP-së, gjeti se :

### **Ankesa është e bazuar**

Nga fotografia e ofruar si provë e cilat gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se, posteri i kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës Shaip Surdulli nga radhët e koalicionit LDK-AKR dega në Dardanë, është vendosur në shtyllë elektrike, pra në rrugën “Skëndërbeu” në hapsira publike, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) i LZP-së e cila e përcakton decidivisht “ *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”

Duke u nisur nga gjendja e theksuar faktike, Paneli konstaton se nga prova e ofruar shihet qartë se nga ana e koalicionit LDK-AKR, është shkelur neni 33 pika (b) i Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, pasi që posteri i kandidatit për deputet nga koalicioni LDK-AKR, është vendosur në një shtyllë elektrike, pra në hapsira publike. Të cilën shkelje e ka pranuar edhe vetë koalicioni LDK-AKR, në përgjigjen në ankesë i datës 07.06.2017.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase koalicioni LDK-AKR kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë njoftu me rregullat zgjedhore, se shkelja nga ana e tyre është përsëritur vazhdimisht gjatë procesit zgjedhor dhe për kundër këtij fakti posteri i kandidatit për deputet nga ky koalicion është i kapur me ngjic në shtyllë elektrike pra në hapsira publike . Po ashtu si rrethanë , PZAP-i e morri edhe faktin që koalicionit në fjalë ia dha mundësin për tu përgjigjur, ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes, ashtu që kanë tërhequr posterin në vendin e palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitë**

Anr.116/2017 më datën 07.06.2017



**Kryesuesi i Panelit  
Zyhdi Haziri**

***Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.***